



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:017374

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05629997

KPPP.nr.1933/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit IPKO Telecommunications L.L.C., me seli në Prishtinë, kundër debitorit D.P.Z. Çeliku, me seli në rr. “Lidhja e Lezhës”, në Vushtrri, duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për përmbarim, jashtë seancës, me datën 26.04.2024, merr këtë

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit IPKO Telecommunications L.L.C dhe debitorit D.P.Z. Çeliku.
- II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, me Aktvendimin CP.nr.61/2021, të datës 19.10.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përmbarimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale, Dhomave të Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt shqyrtimi, nuk bie në kompetencën lëndore të Gjykatës Komerciale, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për arsyet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kreditori lidhur me këtë çështje përmbarimore, fillimisht propozimin për përmbarim e ka paraqitur në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 13.12.2013, ndërsa Gjykata ka lejuar përmbarimin e propozuar përmes Aktvendimit E.nr 1695/13 me datën 30.12.2013.

Sipas Aktvendimit E.nr 1695/13 të datës 31.05.2016, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike është shpallur jo kompetente për të vendosur dhe për të ndërmarr veprime të mëtejshme në këtë çështje përmbarimore, ndërsa pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, lëndën së bashku me të gjitha shkresat e saj ia ka dërguar Gjykatës Themelore në Mitrovicë.

Gjykata Themelore në Mitrovicë sipas Aktvendimit CP.nr 258/2016 të datës 28.12.2020 është shpallur jo kompetente në pikëpamje territoriale dhe lëndën ia ka dërguar për vendosje Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, pas pranimit të lëndës, me Aktvendimin CP.nr 61/21 të datës 01.02.2021, përsëri ka lejuar përmbarimin e propozuar të kreditorit të iniciuar me datën 13.12.2013, i cili përmbarim veçse ishte lejuar paraprakisht sipas Aktvendimit E.nr. 1695/13 me datën 30.12.2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori dhe debitori propozimin me të cilin është lejuar përsëri përmbarimi sipas Aktvendimit CP.nr 61/21 të datës 01.02.2021 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, e kanë pranuar me datën 04.02.2021, ndërsa ndaj të njëjtit propozim nuk është paraqitur fare prapësim nga debitori.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, sipas Aktvendimit CP.nr. 61/2021 të datës 26.02.2021, ka urdhëruar të gjitha Bankat Afariste të licencuara nga BQK, në Republikën

e Kosovës, që të bllokojnë mjetet e debitorit në shumën prej 1145.08 €, me kamatë ligjore prej 3.5 %, meqenëse aktvendimi për caktimin e përmbartimit është bërë i ekzekutueshëm sipas nenit 74 dhe 152 të LPP-së.

Po ashtu nga shkresat e lëndës rezulton se debitori me datën 22.10.2020, ka paraqitur prapësim ndaj Aktvendimit E.nr 1695/13, të datës 30.12.2013, në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, ndërsa i njëjti prapësim nga Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes aktit përcjellës i është dërguar Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri me datën 15.03.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, lidhur me këtë çështje përmbartimore, e cila është trajtuar sipas Aktvendimit për lejimin e propozimit për përmbartim nën shenjën CP.nr 61/2021, 01.02.2021, ka pranuar ekspertizën financiare të datës 09.03.2021, për llogaritjen e kamatës dhe prapësimin e debitorit nuk e ka trajtuar fare, ndërsa me Aktvendimin Cp.nr. 61/2021, të datës 08.07.2021 ka urdhëruar të gjitha Bankat Afariste të licencuara nga BQK, në Republikën e Kosovës, që të bllokojnë mjetet e debitorit dhe atë në emër të borxhit kryesor shumën prej 1145.08 €; në emër të kamatës shumën prej 419.44 €; në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20 €, si dhe në emër të ekspertizës financiare shumën prej 50 €, meqenëse aktvendimi për caktimin e përmbartimit është bërë i ekzekutueshëm sipas nenit 74 dhe 152 të LPP-së, e po ashtu nga fletëkthesat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton se aktvendimi i lartcekur për ekzekutim, është pranuar nga Thesari i Republikës së Kosovës me datën 23.07.2021.

Në rastin konkret nga shkresat e lëndës, rezulton se Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, ka ndërmarr të gjitha veprimet për ekzekutimin e përmbartimit, ndërsa me Aktvendimin CP.nr 61/2021 të datës 19.10.2023 është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike dhe lëndën e ka dërguar në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke marr numrin e ri KPPP.nr 1933/23.

Gjykata Komerciale e Kosovës, vlerëson se rastin konkret pavarësisht faktit që në shkresa të lëndës, është paraqitur prapësimi i debitorit ndaj Aktvendimit E.nr 1695/13, të datës 30.12.2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me vet

faktin që propozimi i kreditorit është lejuar përsëri me Aktvendimin CP.nr 61/21 të datës 01.02.2021 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri dhe ndaj të njëjtit aktvendim nuk ka paraqitur prapësim debitori dhe për më tepër procedura përmbartimore është zhvilluar në drejtim të ekzekutimit të kërkesës së kreditorit, rezulton se kjo çështje përmbartimore nuk është në kompetencë të Gjykatës Komerciale të Kosovës për vendosje.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbartimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.”*

Ndërsa, mjetet juridike në procedure përmbartimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbartimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa,”* ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbartimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbartueshëm për përmbartimin me dhunë.”*

Në rastin konkret, lënda për të cilën është shpallur jo kompetente Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri, nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbartimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, meqenëse në rastin konkret lidhur me këtë çështje përmbartimore është lejuar propozimi i ri dhe procedura është trajtuar sipas Aktvendimin CP.nr 61/21 të datës 01.02.2021, ndaj të cilit nuk është paraqitur prapësim, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbartimore.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbartimore është ekzekutimi i përmbartimit nga gjykata si organ përmbartues, kjo gjykatë vlerëson se pikërisht Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtri është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbartimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për procedurën përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1933/23, datë 26.04.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.